



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008),
Në bazë të nenit 37 dhe nenit 43 të Ligjit Nr.04/L-027 për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe Fatkeqësitë tjera (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 22 / 19 Tetor 2011, Prishtinë), i ndryshuar dhe Plotësuar me Ligjin Nr.08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik, nenit 26 pika 7 dhe 9 të Statutit të Komunës së Deçanit 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit, në mbledhjen e mbajtur me dt.31.05.2024, merr këtë:

VENDIM

Për formimin e grupit punues për hartimin e Planit për Vlerësimin e Rrezikut në territorin e Komunës së Deçanit.

1.Me këtë Vendim, Formohet grupi punues për hartimin e Planit për Vlerësimin e Rrezikut për territorin e Komunës së Deçanit, me këtë përbërje :

1. Izet Zenuni - DMSHSHP / Kryesues ;
2. Gentiana Mazrekaj - DMSHSHP / anëtare ;
3. Shaban Haxhaj - DMSHSHP / anëtar ;
4. Ali Mataj - DMSHSHP / anëtar ;
5. Besim Kameraj - DMSHSHP / anëtar ;
6. Zyra e Kryetarit – Edona Kameraj / anëtare ;
7. Drejtoria për Administratë – Bekim Demukaj / anëtar ;
8. Drejtoria për Urbanizëm – Xheladin Malaj / anëtar ;
9. Drejtoria për Buxhet dhe Financa – Hasan Kuçi / anëtar ;
10. Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale – Agnesa Vokshi / anëtare ;
11. Drejtoria për Arsim – Ramiz Bajramaj / anëtar ;
12. Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural – Syzana Krasniqi / anëtare ;
13. Drejtoria për Inspektion – Mujë Kadrijaj / anëtar ;
14. Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim – Isuf Demhasaj / anëtar ;
15. Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër – Jetmir Avdiu / anëtar ;
16. Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport – Afrim Hasanmetaj / anëtar ;
17. NJPZSH – Besim Selmanaj / anëtar ;
18. KEDS anëtar ;
19. K.R.U. “Hidrodrini” – Deçan / anëtar ;



20. N.P.L. "Higjiena" / anëtar ;
21. Policia / anëtar ;
22. Leotrim Hadergjonaj, anëtar i Kuvendit nga subjekti politik AAK;
23. Lendita Berisha, anëtare e Kuvendit nga subjekti politik AAK;
24. Mon Selmonaj, anëtar i Kuvendit nga subjekti politik PDK;
25. Miftar Ahmetxhekaj, anëtar i Kuvendit nga subjekti politik LDK;
26. Faton Selmanaj, anëtar i Kuvendit nga subjekti politik LVV.

2. Ky grup punues ka për detyrë që të hartojë Planin e Vlerësimit të Rrezikut për territorin e Komunës së Deçanit.

3. Obligohet grupi punues që të veprojë në bazë të ligjeve dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.

4. Grupi punues do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe Plani për Vlerësimin e Rrezikut duhet të jetë i gatshëm deri në muajin nëntor 2024.

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.

6. Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale , si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

Me vendim njoftohen:

- Anëtarët e grupit punues
- Arkivi i komunës

01.Nr.V-2

Deçan, dt. 31.05.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

The image shows a circular official stamp of the Deçan Municipality Council. The stamp contains the text: "REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLICA DEÇANIT", "Kryesuesi i Kuvendit", "Hajdar SUTAJ", and "Komuna e Deçanit". Overlaid on the stamp is a large, stylized handwritten signature in blue ink.



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 51 paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, si dhe nenit 49.1 shkronja (a) të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.05.2024, bie këtë:

V E N D I M PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR SHËNDETËSI

Neni 1

Themelimi

Me këtë Vendim, Themelohet Komiteti për Shëndetësi i Kuvendit të Komunës së Deçanit, në këtë përbërje:


1. Lulavere Selmanaj, anëtare nga subjekti politik AAK
2. Lendita Berisha, anëtare nga subjekti politik AAK
3. Afrim Demhasaj, anëtar nga subjekti politik AAK
4. Sylë Balaj, anëtar nga subjekti politik LDK
5. Faton Selmanaj, anëtar nga subjekti politik LVV

Neni 2

Zgjedhja e kryesuesit

Mbledhjen e parë të Komitetit e thirrë Kryesuesi i Kuvendit, në të cilën mbledhje anëtarët e Komitetit, e zgjedhin Kryesuesin e Komitetit për Shëndetësi.

Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Shëndetësi bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit. Në rast të mungesës së Kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i Komitetit.



Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë

Komiteti për Shëndetësi kryen detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

- Bën monitorimin e punëve dhe aktiviteteve të ndryshme në nivel të komunës nga fusha e shëndetësisë.
- Konsultohet dhe ndihmon Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale në hartimin e dokumentacionit, planeve apo strategjive nga fusha e shëndetësisë dhe mirëqenies sociale.
- Shqyrton dokumentacione nga fusha e shëndetësisë, nxjerrë konkluzione për çështjet e shqyrtuara dhe ep Rekomandime Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit.
- Kryen edhe punë tjera nga fusha e shëndetësisë.

Neni 4

Mandati

Mandati i anëtarëve të komitetit për Shëndetësi është i lidhur me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 18 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë,

Neni 5

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15(pesëmbëdhjetë) dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7(shtatë) ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

01.Nr.V-4/1

Deçan,dt.31.05.2024



Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ



Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 51 paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, si dhe nenit 49.1 shkronja (b) të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.05.2024, bie këtë:


V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR ARSIM

Neni 1 Themelimi

Me këtë Vendim, Themelohet Komiteti për Arsim i Kuvendit të Komunës së Deçanit, në këtë përbërje:

1. Arjan Dobraj, anëtar nga subjekti politik AAK
2. Yllarta Thaqi, anëtare nga subjekti politik AAK
3. Floriana Hulaj, anëtare nga subjekti politik AAK
4. Kadri Tahirukaj, anëtar nga subjekti politik LDK
5. Orges Tafilaj, anëtar nga subjekti politik LVV



Neni 2 Zgjedhja e kryesuesit

Mbledhjen e parë të Komitetit e thirrë Kryesuesi i Kuvendit, në të cilën mbledhje anëtarët e Komitetit, e zgjedhin Kryesuesin e Komitetit për Arsim.

Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Arsim bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit. Në rast të mungesës së Kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i Komitetit.

Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë

Komiteti për Arsim kryen detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

- Bën monitorimin e punëve dhe aktiviteteve të ndryshme në nivel të komunës nga fusha e Arsimit.
- Konsultohet dhe ndihmon Drejtorinë për Arsim në hartimin e dokumentacionit, planeve apo strategjive nga fusha e Arsimit.
- Shqyrton dokumentacione nga fusha e Arsimit, nxjerrë konkluzione për çështjet e shqyrtuara dhe ep Rekomandime Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit.
- Kryen edhe punë tjera nga fusha e Arsimit.

Neni 4

Mandati

Mandati i anëtarëve të komitetit për Arsim është i lidhur me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 18 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë,

Neni 5

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15(pesëmbëdhjetë) dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7(shtatë) ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

01.Nr.V-4/2

Deçan, dt.31.05.2024

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ





Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d) dhe nenit 51 paragrafi 51.2 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 "Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28 e datës 04.06.2008, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MPL) Nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë, si dhe nenit 49.1 shkronja (b) të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, dt.31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.05.2024, bie këtë:

V E N D I M

PËR THEMELIMIN E KOMITETIT PËR KULTURË

Neni 1 Themelimi

Me këtë Vendim, Themelohet Komiteti për Kulturë i Kuvendit të Komunës së Deçanit, në këtë përbërje:

1. Armend Loshaj, anëtar nga subjekti politik AAK
2. Leotrim Hadergjonaj, anëtar nga subjekti politik AAK
3. Elmedina Sadikaj, anëtare nga subjekti politik AAK
4. Shkelqim Tolaj, anëtar nga subjekti politik LDK
5. Teuta Neziraj, anëtare nga subjekti politik LVV

Neni 2 Zgjedhja e kryesuesit

Mbledhjen e parë të Komitetit e thirrë Kryesuesi i Kuvendit, në të cilën mbledhje anëtarët e Komitetit, e zgjedhin Kryesuesin e Komitetit për Kulturë.

Zgjedhja e Kryesuesit të Komitetit për Kulturë bëhet me shumicën e votave të anëtarëve të Komitetit. Në rast të mungesës së Kryesuesit, mbledhjen e kryeson anëtari më i vjetër i Komitetit.



Neni 3

Detyrat dhe përgjegjësitë

Komiteti për Kulturë kryen detyrat dhe përgjegjësitë si vijon:

- Bën monitorimin e punëve dhe aktiviteteve të ndryshme në nivel të komunës nga fusha e kulturës.
- Konsultohet dhe ndihmon Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport në hartimin e dokumentacionit, planeve apo strategjive nga fusha e Kulturës.
- Shqyrton dokumentacione nga fusha e Kulturës, nxjerrë konkluzione për çështjet e shqyrtuara dhe ep Rekomandime Komitetit për Politik dhe Financa dhe Kuvendit.
- Kryen edhe punë tjera nga fusha e Kulturës.

Neni 4

Mandati

Mandati i anëtarëve të komitetit për Kulturë është i lidhur me mandatin e anëtarëve të Kuvendit të Komunës, bazuar në nenin 18 të Udhëzimit Administrativ (MPL) nr.05/2020 për Procedurën e Themelimit, Përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme dhe Komiteteve tjera në Komunë,

Neni 5

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi 15(pesëmbëdhjetë) dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të MAPL-së, si dhe 7(shtatë) ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës në gjuhët zyrtare.

01.Nr.V-4/3

Deçan,dt.31.05.2024

Kryesuesi i Kuvendit

Hajdar SUTAJ



Në bazë të kërkesës së Lidhjes së Historianëve të Kosovës “Ali Hadri” dega në Deçan, të dt.22.04.2024, nr.01/12521, për ndarjen e mjeteve financiare në shumën prej 6,509.00 €, për organizmin dhe mbajtjen e Konferencës shkencore “Deçani mes pushtimit dhe çlirimit-25 vjetori i çlirimit të Deçanit”, në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 shkronja d), nenit 17 shkronja (r), nenit 40 paragrafi 40.2 shkronja (c) të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040 “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës” nr.28 e datës 04.06.2008, dhe nenit 26 pika 3. të Statutit të Komunës së Deçanit, 01.Nr.IX-5, të datës 31.10.2019, Kuvendi i Komunës së Deçanit në mbledhjen e mbajtur me dt.31.05.2024, merr këtë:

V E N D I M

PËR NDARJEN E MJETEVE BUXHETORE PËR ORGANIZIMIN E KONFERENCËS SHKENCORE
“DEÇANI MES PUSHTIMIT DHE ÇLIRIMIT-25 VJETORI I ÇLIRIMIT TË DEÇANIT”

I.

Merret Vendimi për ndarjen e mjeteve financiare në vlerë prej 6,509.00 €, për organizmin dhe mbajtjen e Konferencës shkencore “Deçani mes pushtimit dhe çlirimit-25 vjetori i çlirimit të Deçanit”, e cila do të organizohet nga Lidhja e Historianëve të Kosovës “Ali Hadri” dega në Deçan.

II.

Mjetet financiare në vlerë prej 6,509.00 €, (gjasht mijë pesë qindënenteuro) ndahen nga kategoria Subvencione, Zyra e Kryetarit, kodi ekonomik: 10/631/16015/200/0111.

II.

Për ekzekutimin e këtij vendimi do të kujdeset, Drejtoria për Buxhet dhe Financa e Komunës së Deçanit.

III.

Vendimi hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit dhe 15 dit pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për vetëqeverisje lokale, si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb faqen e Komunës.

IV.

Me Vendim njoftohen: MF-Departamenti për Buxhet dhe Financa, Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Buxhet dhe Financa dhe Arhivi i KK Deçan.

01.Nr.V-5

Deçan, dt. 31.05.2024

KUVENDI I KOMUNËS SË DEÇANIT

	CHESJE - DEÇANI - KUVENDI I REPUBLICA E KOSOVËS - REPUBLIKA E DEÇANIT - REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E DEÇANIT - OPSTINA DEÇAN
NR. VETEMENTI	R.K-Deçani AS 17786
NR. DOKUMENTI	01 06.06.24
NR. DOKUMENTI	
NR. DOKUMENTI	

Faqe 1 nga 1

Kryesuesi i Kuvendit
Hajdar SUTAJ

